



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



ZKA

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË MINISTRISË SË DREJTËSISË PËR VITIN 2025

Prishtinë, qershor 2026

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Çështjet e zgjidhura gjatë procesit të auditimit
- 4 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuar nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Ministrisë së Drejtësisë për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Ministrisë së Drejtësisë (MD), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Drejtësisë, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme, Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Ministrisë së Drejtësisë kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- A1 Vonesa dhe mangësi në përfundimin e projektit në IML vlerë 814,229€;
- A2 Dobësi në aplikimin e procedurës së negociuar pa publikim;
- B1 Detyrimet kontigjente ishin mbivlerësuar për 403,187€ dhe njëkohësisht nënvlerësuar për 56,000€ si rezultat i mos përditësimit të të dhënave dhe gabimeve në regjistrim; dhe
- B2 Në tri raste, MD kishte dobësi në zbatimin e kushteve kontraktuale dhe mos aplikim të penaliteve për vonesa.

Më gjerësisht shih nënkaptullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Çështje tjetër

- 1 Pagesat nga subvencionet dhe transferet lidhur me mbrojtjen juridike dhe mbështetjen financiare të personave potencial të akuzuar pranë Dhomave të Specializuara të cilat kanë qenë të klasifikuara (niveli i kufizuar) nuk janë pjesë e këtij raporti. Këto pagesa auditohen ndaras dhe përgatitet një raport i veçantë i auditimit i cili do të ju komunikohet vetëm palëve përgjegjëse.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Ministrja është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë së Drejtësisë.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Ministrisë së Drejtësisë është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Ministrisë së Drejtësisë në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Ministrisë së Drejtësisë me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontroleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Ministrisë së Drejtësisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve.

Ministria ka shpenzuar 82% të buxhetit final ose 44,263,281€. Fushat me përmirësim kanë të bëjnë me menaxhimin e pasurive kapitale dhe detyrimeve kontingjente.

Ndërsa, sa i përket mos pajtueshmërisë me legjislacionin dhe rregulloret e zbatueshme, ministria duhet të i forcoj edhe më tej kontrollet sa i përket menaxhimit të kontratave ku kishte mangësi në fushën e prokurimit, vonesa në realizimin e punimeve dhe përdorimin e procedurës së negociuar pa publikim. Po ashtu duhet të përshpejtoj procesin e finalizimit të klasifikimit dhe grupimit të pozitave të punës në IML.

Ky raport ka rezultuar me gjashtë rekomandime, prej tyre tre janë rekomandime të reja dhe tre rekomandime të përsëritura. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 5.

2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A1 - Vonesa në përfundimin e punimeve dhe tejkalim i sasive të parapara

Gjetja Sipas kushteve kontraktuale janë përcaktuar afatet e realizimit të projekteve të kontraktuara bazuar në planin dinamik për përmbushjen e secilës kontratë.

Gjatë auditimit dhe verifikimit të gjendjes në terren, është konstatuar se projekti “Renovimi i Kulmit IML”, me vlerë kontrate prej 814,229€, nuk është realizuar brenda afateve kontraktuale, duke shkaktuar vonesa në përmbushjen e obligimeve. Kontrata është nënshkruar më 25.09.2024, me afat përfundimi deri më 30.05.2025, përkatësisht 150 ditë pune, ndërsa projekti nuk ishte përfunduar as gjatë fazës së auditimit.

Përveç vonesës, analiza e situacioneve të punimeve tregoi se në disa pozicione sasitë e realizuara deri në momentin e auditimit kishin tejkaluar ato të parapara në paramasë si:

- Në pozicionin 8.18 Furnizimi dhe transporti me pllaka graniti, vlera e kontraktuar ishte 10,020€, ndërsa vlera e realizuar ishte 17,578€, me një tejkalim prej 7,558€;
- Në pozicionin 9.5 Furnizimi dhe montimi i knaufit, vlera e kontraktuar ishte 6,000€, ndërsa vlera e realizuar ishte 25,582€, me një tejkalim prej 19,582€; dhe
- Në pozicionin 40 rrjeti i internetit, montimi dhe finalizimi, vlera e kontraktuar ishte 2,592€, ndërsa vlera e realizuar ishte 7,200€, me një tejkalim prej 4,608€.

Vlera e përgjithshme e kontraktuar për këto tri pozicione ishte 18,612€, ndërsa vlera e realizuar arriti në 50,360€, duke rezultuar në një tejkalim prej 31,748€.

Sipas informacioneve të pranuara, vonesat në realizimin e projektit lidhen me moslirimin me kohë të hapësirave nga ana e stafit, temperaturat e ulëta gjatë periudhës dimërore, si dhe mungesën e një inxhinieri të makinerisë për pranimin e një pjese të punimeve.

Ndikimi Vonesat në realizimin e projektit kanë rezultuar në mos përfundimin e punimeve brenda afatit kontraktual dhe shtyrje të vënies në funksion të objektit të IML-së, duke vonuar përfitimin e shërbimeve të planifikuara. Ndërkohë, tejkalimet në disa pozicione krahasuar me paramasën kanë rritur rrezikun për shpenzime shtesë dhe kanë ndikuar negativisht në kontrollin e kostos financiare të projektit.

Rekomandimi A1 Ministrja duhet të forcojë planifikimin dhe koordinimin ndërmjet njësive përgjegjëse para dhe gjatë zbatimit të projekteve, duke siguruar disponueshmërinë e hapësirave dhe trajtimin me kohë të faktorëve që ndikojnë në afatet e realizimit, si dhe të sigurojë mbikëqyrje më të mirë të sasive të realizuara ndaj atyre të parapara në paramasë, për të shmangur vonesat dhe tejkalimet në përmbushjen e obligimeve kontraktuale.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**Çështja A2 - Dobësi në përdorimin e procedurës së negociuar pa publikim**

Gjetja Sipas nenit 35 të Ligjit për Prokurimin Publik, procedura e negociuar pa publikim mund të përdoret vetëm në raste të emergjencës ekstreme, kur rrethanat janë objektivisht të verifikueshme, të paparashikueshme dhe nuk lejojnë kohë për zhvillimin e një procedure tjetër. Përdorimi i kësaj procedure nuk e liron Autoritetin Kontraktues nga obligimi për të përcaktuar dhe zbatuar kushtet kryesore të kontratës, përfshirë afatet e dorëzimit, sasisë, çmimet dhe garancitë.

Gjatë vlerësimit të procedurës së prokurimit “Furnizimet e pastrimit” në vlerë 119,497€, MD kishte aplikuar procedurën e negociuar pa publikim, duke u thirrur në nevojën emergjente për furnizim me material higjienik. Megjithatë, nga dokumentet e pranimit është vërejtur se furnizimi nuk ishte realizuar brenda afatit të përcaktuar me kontratë prej 3 ditësh, por me vonesa deri në 15 ditë. Madje, për këto vonesa nuk ishin aplikuar masat e parapara me kontratë.

Kjo ka ndodhur si rezultat i mangësisë në planifikimin dhe monitorim jo të mjaftueshëm në zbatimin e kontratës.

Ndikimi Vonesat në dorëzim e furnizimeve e dobësojnë arsyetimin për përdorimin e procedurës emergjente, pasi qëllimi i saj është sigurimi i furnizimit të shpejtë. Kjo ka krijuar rrezik që nevojat emergjente të mos përmbushen me kohë dhe ka kufizuar përfitimin që pritej nga përdorimi i një procedure më pak konkurruese.

Rekomandimi A2 Ministrja duhet të sigurojë që procedura e negociuar pa publikim, sipas Nenit 35, të përdoret vetëm kur emergjenca është e arsyetuar dhe e dokumentuar me dëshmi të mjaftueshme. Gjithashtu, kontratat e lidhura për nevoja emergjente duhet të monitorohen me kujdes, në mënyrë që furnizimet të realizohen brenda afateve të përcaktuara, ndërsa në rast vonesash duhet të dokumentohen arsyet dhe të aplikohen penalet apo masat e tjera të parapara me kontratë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**Çështja B1 - Prezentim jo i saktë i detyrimeve kontingjente**

Gjetja Rregullorja MF nr.01/2017, Neni 18 obligon Organizatat buxhetore të raportojnë të gjitha detyrimet kontingjente në PVF. Detyrim kontingjent është një detyrim i cili materializohet vetëm pas ndodhjes së disa ngjarjeve të caktuara në të ardhmen.

Gjatë auditimit u konstatua se dy lëndë me vlerë totale 29,421€, ndonëse sipas dokumentacionit mbështetës rezultojnë të mbyllura, vazhdonin të figuronin në listën e detyrimeve kontingjente.

Po ashtu, u identifikuan pasaktësi në vlerësimin e detyrimeve kontingjente, si:

- Në një rast, detyrimi kontingjent prej 374.14€ ishte regjistruar gabimisht si 374,140€, duke rezultuar në mbivlerësim prej 373,766€; dhe
- Në rastin tjetër, detyrimi kontingjent prej 57,000€ ishte regjistruar si 1,000€, duke rezultuar në nënvlerësim prej 56,000€.

Kjo ka ndodhur si pasojë e mospërditësimi me kohë të evidencave për detyrimet kontingjente nga zyra ligjore, bazuar në të dhënat e fundit të proceseve kontestimore dhe kujdesit jo të duhur gjatë regjistrimit të tyre.

Ndikimi

Mospërditësimi i evidencave për detyrimet kontingjente si dhe gabimet gjatë regjistrimit të tyre, që kanë rezultuar në mbivlerësim/nënvlerësim të vlerës së detyrimeve, ndikojnë në saktësinë, plotësinë dhe besueshmërinë e informacionit financiar të shpalosur në pasqyrat financiare.

Rekomandimi B1

Ministrja duhet të sigurojë një koordinim më të mirë ndërmjet zyrës ligjore dhe ZKF-së, në mënyrë që detyrimet kontingjente, para se të paraqiten në Pasqyrat Financiare Vjetore, të rishikohen lidhur me statusin e tyre, të azhurnohet lista dhe ato të prezantohen saktë dhe në mënyrë të plotë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B2 - Dobësi në zbatimin e kushteve kontraktuale dhe mosaplikimi i penaliteteve për vonesa

Gjetja

Sipas kushteve kontraktuale, operatorët ekonomikë janë të obliguar të realizojnë furnizimet, shërbimet apo punët brenda afateve të përcaktuara. Në rast vonesash, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë dhe obligim të shqyrtojë e të aplikojë penalitetet apo masa të tjera kontraktuale. Gjithashtu, Kushtet e Veçanta kanë përcaktuar që furnizuesi të dorëzojë sigurimin e kontratës në vlerë 10% të vlerës së kontratës, nga banka apo kompania e sigurimit, me vlefshmëri 12 muaj nga data e nënshkrimit.

Gjatë Gjatë auditimit në tri raste, u konstatuan dobësi në zbatimin e kushteve të kontratave, si:

- Në kontratën "Rregullimi i dysHEMEVE me epox" në vlerë 65,450€, furnizimi nuk është realizuar plotësisht brenda afatit 30-ditor, ku për një shumë prej 1,920€ është evidentuar vonesë prej 25 ditësh, ndërsa nuk janë aplikuar penalitetet e parapara;
- Në kontratën për "Furnizim me pajisje të sigurisë për SHKK", 24,999€, siguri i kontratës nuk ka mbuluar plotësisht periudhën e kërkuar me Kushtet e Veçanta; dhe
- Në kontratën për "Mirëmbajtje e ndërtesave", në vlerë 11,950€, malli u dorëzua jashtë afatit kontraktual, ndërsa nuk ishin aplikuar penale në pagesë për vonesën në dorëzim.

Kjo ka ndodhur për shkak të monitorimit jo të mjaftueshëm të zbatimit të kontratave dhe mos verifikimit të plotë të afateve të dorëzimit, vlefshmërisë së sigurimit të kontratës dhe aplikimit të penaleve para pranimit të mallrave dhe kryerjes së pagesave.

Ndikimi

Vonesat në realizimin e kontratave dhe mos përmbushja e tyre ndikon negativisht në realizimin me kohë të furnizimeve dhe punëve të planifikuara. Njëherit, mungesa e sigurisë së ekzekutimit dhe mos aplikimi i

penaliteve rrezikon që operatorët ekonomikë të mos respektojnë afatet e përcaktuara dhe ndikon negativisht në menaxhimin efektiv të kontratave.

Rekomandimi B2

Ministrja duhet të sigurojë që para çdo pagese të verifikohet nëse janë përmbushur plotësisht kushtet kontraktuale, përfshirë afatet e dorëzimit, vlefshmërinë e sigurimit të kontratës dhe aplikimin e penaliteve. Pagesat duhet të realizohen vetëm pas konfirmimit të përmbushjes së plotë të kushteve ose trajtimit formal të devijimeve sipas kontratës.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.2.1 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për paga dhe mëditje ishte 19,795,685€ prej tyre ishin shpenzuar 19,708,780€. Numri i të punësuarve sipas buxhetit ishte 2169 punonjës, ndërsa në fund të vitit numri i tyre ishte 1987.

Çështja A3 - Mos finalizimi i klasifikimit dhe grupimit të pozitave të punës

Gjetja Sipas Rregullores (QRK) nr.06/2024 për klasifikimin e vendeve të punës në shërbimin civil neni 34 ceket se "Obligohen institucionet në fushën e veprimit të kësaj Rregulloreje të përgatisin klasifikimin dhe grupimin e pozitave të punës në pajtim me këtë Rregullore dhe katalogun e vendeve të punës, jo më vonë se tre (3) muaj nga hyrja në fuqi e kësaj Rregulloreje.

Nga auditimi u konstatua se në Institutin për Mjekësinë Ligjore (IML) ende nuk është finalizuar klasifikimin dhe grupimin e pozitave të punës, edhe pse afati i përcaktuar për këtë obligim ishte fundi i muajit maj 2024. Aktualisht, klasifikimi ndodhet në procedurë shqyrtimi në Zyrën Ligjore të Ministrisë së Drejtësisë.

Si pasojë e mos finalizimit të këtij procesi, ka reflektuar që shumë pozita udhëheqëse dhe pozita të tjera në IML në vazhdimësi të mbulohen me ushtrues detyre. Gjatë vitit 2025, janë evidentuar gjithsej 10 pozita udhëheqëse të mbuluara me ushtrues detyre.

Kjo ka ndodhur si rezultat i mungesës së veprimeve të nevojshme organizative dhe administrative nga zyrtarët përgjegjës për zbatimin e kërkesave të Rregullores brenda afatit të caktuar.

Ndikimi Mos finalizimi i klasifikimit dhe grupimit të pozitave të punës në IML brenda afatit të kërkuar ligjor përveç që nuk është pajtueshmëri me kërkesat ligjore, ka reflektuar edhe në mbulimin e shumë pozitave me ushtrues detyre. Kjo mund të ndikojë në vendimmarrje jo të qëndrueshme dhe menaxhim jo të mirë të burimeve njerëzore.

Rekomandimi A3 Ministrja në bashkëpunim me Drejtorin e Përgjithshëm të Instituti për Mjekësinë Ligjore duhet të ndërmarrin hapat e nevojshëm për finalizimin e klasifikimit dhe grupimit të pozitave të punës në përputhje me Rregulloren (QRK) nr. 06/2024 dhe katalogun e vendeve të punës.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.2 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale për vitin 2025 është 95,775,702€, pasurive jokapitale është 863,281€, si dhe e stoqeve 907,640€.

Çështja B3 - Nënvlërësim i regjistrave të pasurisë në PFV

Gjetja

Sipas Rregullores Financiare MF nr. 02/2013 - Për Menaxhimin e pasurisë jo financiare në nenin 3 përcaktohet që Regjistri i Përgjithshëm i Pasurive - është një listë e plotë dhe e saktë e të gjitha pasurive jo financiare të zotëruara nga organizatat buxhetore, që nënkupton regjistrin e pasurive kapitale, pasurive jo kapitale dhe stoqeve që azhurnohen rregullisht, dhe që, përveç përdorimit për menaxhim të pasurive, do të përdoret edhe për të mbështetur të dhënat e raportuara në pasqyrat financiare. Ne identifikuam se pasuritë e paregjistruara në regjistrat kontabël përkatës ishin te:

Nga auditimi kemi vërejtur se regjistri i pasurive kapitale mbi 1,000€ ishte nënvlerësuar për vlerën 35,137€. Kjo ka ndodhur pasi investimet kapitale “Zgjerimi i Institutit të Forenzikës” në vlerë prej 21,547€ dhe “Sistemi i ujitjes në SHKK” në vlerë prej 13,590€ nuk janë regjistruar në SIMFK gjatë vitit 2025. Vlen të theksohet se këto dy pasuri janë regjistruar në vitin 2026.

Këto mangësi kanë ardhur si rezultat i asaj që pagesat ishin bërë në fundvit dhe zyrtari i pasurisë nuk kishte arritur t'i regjistroj brenda periudhës raportuese.

Ndikimi

Mos regjistrimi në kohë i pasurive ndikon në raportim jo të saktë të vlerës së pasurive, duke rezultuar në nënvlerësim dhe prezantim jo të drejtë të tyre në Pasqyrat Financiare Vjetore.

Rekomandimi B3

Ministrja duhet të forcojë mekanizmat e kontrollit të brendshëm për të evituar nënvlerësimin e pasurive, si dhe të siguroj përmes zyrtarëve të pasurive dhe ZKF që çdo pasuri e blerë të jetë prezantuar saktë dhe në kohën e duhur në PFV.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Çështjet e zgjidhura gjatë procesit të auditimit

Gjate auditimit u identifikuan disa çështje që iu komunikuan menaxhmentit dhe u zgjidhen në mënyrë efektive gjatë auditimit aktual. Ato nuk kërkojnë ndonjë veprim të mëtutjeshëm dhe raportohen vetëm me qëllim të dokumentimit të komunikimit në fjalë, veprimeve të ndërmarra dhe rezultateve të tyre. Këto ishin si më poshtë:

Çështjet materiale të cilat ne i kemi identifikuar dhe janë përmirësuar gjatë kohës së auditimit

Çështja 1 Gabimet e identifikuara në prezantimin e PFV

Gjetja

Gjatë rishikimit të pasqyrave finaciare vjetore u identifikuan disa mospërputhje dhe prezantime jo të sakta si:

- Te neni 13 Pasqyra e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme te kolona e parë Llogaria e vetme e Thesarit te burimet e fondeve - Pranime tjera është kërkuar të korrigohet vlera e Depozitave), duke përfshirë të gjitha daljet e depozitave nga SHKK dhe AAPSK. Po ashtu, te kolona e njëjtë - shfrytëzimi i fondeve te Pagesa tjera është kërkuar të prezantohet vlera e njëjtë e depozitave;
- Te Neni 14 Raporti i ekzekutimit të buxhetit te Hyrja e parasë së gatshme- Të Hyrat tatimore shënimi 8, është kërkuar të mos ketë vlerë pasi që Ministria nuk ka të hyrat tatimore (as te realizimi, Buxheti final dhe Buxheti fillestar);

Te të hyrat jo tatimore shënimi 9, te kolona e buxhetit final dhe fillestar është kërkuar të prezantohet vlera e planifikuar nga makro për të hyrat jo tatimore;

Te grantet e përcaktuara të donatorëve shënimi 11 është kërkuar të vendoset vlera e donacioneve të pranuar gjatë vitit, ashtu siç është prezantuar te buxheti final. Ndërsa te pjesa e buxhetit fillestar është kërkuar të mos ketë vlerë;

Po ashtu te shënimi 12 të tjera, është kërkuar të përfshihen të gjitha hyrjet e vitit 2025 të depozitave nga SHKK dhe AAPSK. Te ky shënim është kërkuar të prezantohen edhe të hyrat nga kodi ekonomik 61000. Këto duhet të reflektojnë edhe te shënimet shpjeguese;

- Te Neni 14 Raporti i ekzekutimit të buxhetit te kolona e buxhetit fillestar dhe final te Dalja e parasë së gatshme vlerat e prezantuara te shënimi 2 tek kategoria paga dhe shtesa si dhe te shënimi 3 tek mallra dhe shërbime vlerat e tyre është kërkuar të jenë sipas buxhetit fillestar dhe të SIMFK-së;
- Te neni 14.6 te Dalja e parasë së gatshme vlerat e prezantuara për kolonën Buxheti përfundimtar SIMFK te kategoria paga dhe shtesa si dhe te mallra dhe shërbime vlerat e tyre është kërkuar të jetë sipas buxhetit përfundimtar të SIMFK-së; dhe
- Tek Shënimet shpjeguese është kërkuar të jenë konsistente me shënimet e prezantuara në tabelat kryesore te neni 13 dhe 14.

Veprimi i kërkuar Menaxhmentit të entitetit i është kërkuar që të ndërmarrë veprime për t'i korigjuar Pasqyrat Financiare Vjetore, në mënyrë që ato të paraqesin saktë gjendjen financiare në përputhje me rregullat e raportimit financiar.

Rezultati Menaxhmenti kishte marrë veprime korigjuese për paraqitje të drejtë dhe të saktë të PFV gjatë procesit të auditimit dhe kishte bërë korigjimet për çështjet që i kemi sugjeruar. Këto gabime kanë rezultuar për shkak të mos funksionimit të kontrolleve të brendshme, prandaj ne ju tërheqim vëmendjen se nëse këto gabime përsëriten në PFV e vitit vijues atëherë çështja do të rezultojë me rekomandim në raportin e auditimit

4 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁵	2025 Shpenzimet	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet
Burimet e fondeve	57,221,749	54,304,793	44,263,281	40,371,469	35,204,319
Grante Qeveritare - Buxheti	57,046,549	54,012,612	44,179,780	40,371,469	35,161,315
Të bartura nga viti i kaluar	0	80,200	59,105	0	30,885
Të hyrat vetanake	175,200	175,200	19,863	0	0
Donacionet e jashtme	0	36,781	4,533	0	12,120

Buxheti final është më i ulët se buxheti fillestar për 2,916,956€. Ndryshimet buxhetore kanë ardhur si rezultat i rishikimit buxhetor dhe vendimeve të qeverisë.

Në vitin 2025, Ministria ka shpenzuar 82% të buxhetit final ose 44,263,281€ me një ulje prej 12% në raport me vitin e kaluar. Sidoqoftë, shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.


Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2025 Shpenzimet	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	57,221,749	54,304,793	44,263,281	40,371,469	35,204,319
Pagat dhe mëditjet	18,413,536	19,795,685	19,708,780	16,776,813	15,424,957
Mallrat dhe shërbimet	10,866,444	11,366,544	10,602,808	10,450,796	7,245,277
Komunalitë	1,088,769	1,088,769	1,004,798	1,008,078	978,326
Subvencionet dhe transferet	11,848,000	10,550,310	10,543,045	10,106,444	10,866,022
Investimet Kapitale	15,005,000	11,503,484	2,403,850	2,029,338	689,737

MD gjatë vitit 2025 kishte lëvizje buxhetore nëpër kategori. Megjithatë, të gjitha lëvizjet/ndryshimet ishin të mbështetura me vendime përkatëse të Ministrisë së Financave dhe Qeverisë. Sqarimet rreth ndryshimeve buxhetore janë shpalosur si në vijim:

- Buxheti final për paga dhe mëditje në krahasim me buxhetin fillestar ishte rritur për 1,382,149€. Kjo rritje ishte bërë me vendimet e Qeverisë për shkak të ngritjes së koeficientit për 0.5. Realizimi i buxhetit final ishte 100%;
- Buxheti final për mallra dhe shërbime në krahasim me buxhetin fillestar ishte rritur për 500,100€. Kjo rritje ishte si rezultat i vendimeve të Qeverisë për rregullime dhe transfere të brendshme. Realizimi i buxhetit tek kjo kategori ishte 93%;
- Buxheti fillestar dhe final për shpenzime komunale nuk kishte ndryshime, ndërsa realizimi i buxhetit ishte 92%;
- Buxheti final për subvencione dhe transfere në krahasim me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 1,297,690€. Ky zvogëlim ishte si rezultat i vendimeve të Qeverisë. Shpenzimi në këtë kategori ishte 100%; dhe
- Buxheti final për investime kapitale ishte më i ulët për 3,501,516€ krahasuar me buxhetin fillestar dhe u realizua vetëm në nivelin 21%. Në këtë nivel të realizimit kanë ndikuar mos realizimi i projekteve kapitali si: Projekti kapital “Renovimi i Objekteve të Qendrës së Paraburgimit të Gjilanit sipas rekomandimeve të shtetit danez në vlerë prej 1.3 milion dhe Ndërtimi i objektit të punëtorive në Qendrën e Paraburgimit në Gjilan në vlerë prej 1,4 milion, dy lloje për shkak të ankesave të operatorëve ekonomike gjatë fazës së tenderit. Gjithashtu, projekti për zgjerimin e Institutit të Forenzikës (1.1 milion €) u kontraktua vetëm në fund të vitit 2025, ndërsa projektet për ndërtimin e Qendrës së Paraburgimit dhe Qendrës Korrektuese në Prizren (4.1 milion €) dhe Institucionit Korrektues për Femra në Lipjan (3.5 milion €) u anuluan, pasi ofertat e pranuar tejkalonin buxhetin e planifikuar.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2025



Të hyrat e realizuara nga MD në 2025 ishin në vlerë 239,564€. Të hyrat realizohen nga shitja e pasurisë së konfiskuar, Licenca për aktivitete individuale dhe profesionale të lira, gjoba tjera, kompensimet e dëmeve nga Kompanitë e Sigurimit etj.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2025 Pranimet	2024 Pranimet	2023 Pranimet
Totali i të hyrave	15,570,874	15,570,874	239,564	6,621,651	106,343
Të hyrat jo tatimore	15,570,874	15,570,874	223,764	6,621,089	106,343
Të hyrat tjera	0	0	15,800	562	

5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të e vitit 2024 ka rezultuar me shtatë rekomandime. Ministria kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2025, ne kemi identifikuar se katër rekomandime ishin zbatuar, dhe tre rekomandime ishin përsëritur siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4. Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2024	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për konkluzion	Ministrja duhet të sigurojë përmes menaxherit të prokurimit që kur OE nuk përmbush kontratën t'iu konfiskohet siguria e ekzekutimit. Po ashtu, duhet siguruar një monitorim të rregullt e sistematik të afateve në lidhje me furnizimin e mallit që të bëhet në kohë në të kundërtën të bëhet aplikimi i penaleve.	Edhe në vitin 2025 janë identifikuar rastet e njëjta.	Nuk është adresuar
2.	Baza për konkluzion	Ministrja përmes menaxher-es/it të personelit duhet të siguroj se janë ndërmerr të gjitha veprimet ligjore për mbulimin e pozitave me ushtrues detyre me pozita të rregullta.	Gjatë viti 2025 ZKA kishte nxjerr vendim për shfuqizim të ushtruesve të detyrës që kishin tejkaluar afatin ligjor.	I zbatuar

3.	Baza për konkluzion	Ministrja, përmes menaxherit të prokurimit dhe njësisë kërkuese, duhet të sigurojë përfshirjen e specifikimeve teknike të qarta dhe të matshme në dosjet e tenderit në mënyrë që të mos rezultojnë me keqinterpretime. Ndërsa lidhja e kontratës për projekt të bëhet vetëm kur fondet janë siguruar, duke mos tejkaluar buxhetin e planifikuar.	Në vitin 2025 nuk kemi identifikuar raste të tilla.	I zbatuar
4.	Investimet kapitale	Ministrja duhet të sigurojë që janë ndërmarrë veprime konkrete në mënyrë që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit apo të bëhet ridestinimi në kategorinë përkatëse dhe që pagesa dhe regjistrimi i tyre të bëhet sipas kategorive ekonomike adekuate, për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre në Pasqyra Financiare.	Në vitin 2025 nuk kemi identifikuar raste të tilla.	I zbatuar
5.	Pasuritë	Ministrja duhet të forcojë mekanizmat e kontrollit të brendshëm për të evituar nënvlerësimin e pasurive, si dhe të sigurojë përmes zyrtarëve të pasurive dhe ZKF që çdo pasuri e blerë apo e dhuruar të jetë prezantuar saktë dhe në kohën e duhur në PFV.	Edhe në vitin 2025 janë identifikuar rastet e njëjta.	Nuk është adresuar
6.	Obligimet e papaguara	Ministria duhet të përmirësojë planifikimin financiar dhe menaxhimin e mjeteve financiare në dispozicion, të forcojë kontrollet e brendshme dhe të sigurojë që të gjitha faturat e pranuar të paguhen brenda afateve të përcaktuara, me qëllim shmangien e penalteteve dhe bartjes së detyrimeve në vitin pasues.	Në vitin 2025 nuk kemi identifikuar raste të tilla.	I zbatuar
7.	Detyrimet Kontingjente	Ministrja duhet të sigurojë një koordinim më të mirë në mes zyrës ligjore dhe ZKF, në mënyrë që detyrimet kontingjente para se të paraqiten në Pasqyrat Vjetor Financiar të rishikohen lidhur me statusin e tyre, të azhurnohet lista dhe të prezantohen saktë dhe në mënyrë të plotë.	Edhe në vitin 2025 janë identifikuar rastet e njëjta.	Nuk është adresuar

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Shkelqim Xhema, Drejtor i Auditimit



Ariana Berisha Rexhëbeqaj, Udhëheqëse e ekipit



Antigona Çitaku, Anëtare e ekipit



Adelina Selmani, Anëtare e ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA
 I PUBLIC OF KOSOVO
 QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA
 GOVERNMENT OF KOSOVO
 MINISTRIA E DREJTËSISË-MINISTARSTVO PRAVDE
 MINISTRY OF JUSTICE
 Nr. Be No: 01-812
 Data/Date: 15/06/2026
 Sitja/Doc: -1-
 PRISHTINE



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
 ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
 NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE
 15-10-2026
 Nr. Prot. 1044
 Nr. Prot. 1
 Nr. Prot. 47
 Nr. Prot. 03

Republika e Kosovës
 Republika Kosova-Republic of Kosovo
 Qeveria - Vlada-Government
 Ministria e Drejtësisë – Ministarstvo Pravde – Ministry of Justice

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2025 dhe zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- Kam pranuar draft Raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare Vjetore të Ministrisë së Drejtësisë për vitin 2025;
- Pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet e paraqitura në Raport dhe nuk kam komente shtesë lidhur me përmbajtjen e tij;
- Brenda afatit prej 30 ditësh nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj Planin e Veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë masat e ndërmarra, afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Donika Gërvalla-Schwarz

Ministre në detyrë e Ministrisë së Drejtësisë

Data: 11/06/2026, Prishtinë,

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁶ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁷, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.